



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
"STRATI" Sh.p.k.



Adresa: Rr. "Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, eëë.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 4979

Nr. 61 Prot.

Tiranë, më 10.01.2020

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit

Për dijëni : Shoqërisë "Met-Plast" Sh.p.k.

Shoqëria "AE Team" Sh.p.k.

Në Tiranë, sot më datë 10.01.2020,

Unë **Edvin Malotaj**, përmbarues gjyqësor privat pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, i pajisur me çertifikatë Nr. 106, Maj 2012 lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të "Urdhërit të Ekzekutimit" Nr. 8649 Akti, datë 20.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se në datë 19.12.2019 është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe lidhur kontrata e shërbimit, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., për ekzekutimin e titullit ekzekutiv faturat tatimore të shitjes, lëshuar nga Shoqëria "AE Team" Sh.p.k. në cilësinë e Shitësit për Shoqërinë "Met-Plast" Sh.p.k., në cilësinë e Blerësit, për të cilat është lëshuar urdhëri i ekzekutimit Nr. 8649 Akti, datë 20.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë:

Kreditor : Shoqëria "AE Team" Sh.p.k.

Debitor : Shoqëria "Met-Plast" Sh.p.k.

Me Objekt : Pagim fature

Me vendimin Nr. 8649 Akti, datë 20.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur:

"Pranimin e kërkesës.

Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv fatura tatimore shitje:

Fatura Nr. Serial 69844047 dhe Nr. 247, datë 17.11.2018, që përmban detyrimin monetar prej 73,900 lekë.

Fatura me Nr. Serial 69844100 dhe Nr. 300, datë 08.12.2018, që përmban detyrimin monetar prej 96,745 lekë lëshuar nga shoqëria "AE Team" Shp.k. me Nipt L81319029E, me seli në Kashar, Autostrada Tiran – Durrës, km. 8, rruga "Dhaskal Todri", Nr. 7, ZK 2105, nr. pasurie 187/14, për blerësin/debitor shoqërinë Met-Plast Sh.p.k. me nipt J62223003D me seli në Tiranë, rruga "Josif Pashko", Kombinat.

Ngarkohet Zyra e Përmbarimit për ekzekutimin e këtij vendimi.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë".

Me shkresën Nr. 7053 Prot., datë 19.12.2019 debitorit i është komunikuar lajmërimi për ekzekutimin vullnetar. Në kushtet kur pas përfundimit të afatit nga ana e palës debitore nuk është shlyer detyrimi, është vendosur sekuestro mbi aktivet e palës debitore.

URDHËROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit të heqë masën e sekuestros konservative mbi aktivet që zotëron pala debitore:
 - Shoqëria "Met-Plast" Sh.p.k. me NIPT J62223003D me Administrator **Z. Sokol Korbi**, duke revokuar urdhrin tonë të mëparshëm Nr. 7255 Prot., datë 30.12.2019.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Përmbarues Gjyqësor Privat

Edvin Malotaj

